



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:038756
Datë: 10.12.2018
Numri i dokumentit: 00185482

P. nr. 298/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN–DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, sipas gjykatëses së vetme gjykuese, **Luljete Shabani**, në lëndën penale të akuzuarës **Rr.C.** nga Prishtina, për shkak të veprës penale **Rrezikimi i Trafikut Publik** nga neni 378, par. 6, lidhur me par. 1 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan–Departamenti i Përgjithshëm, PP. II. nr. 469/2017, e datës 21.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqsor, më datë 26.11.2018, në prezencë të palëve, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 10.12.2018, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **Rr.C.**, nga babai **M.** dhe nëna **S.**, e lindur **I.**, e lindur më datë ... në Prishtinë, ku edhe jeton, në lagjen “...”, rr. “...”, pn., e pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovë, më parë e padënuar, as nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj saj,

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse, më datë 17.03.2017, rreth orës 17.10 min. në rr. e Ferizajt në Gjilan, me të arritur te udhëkryqi para NP. “Dita GSH”, duke drejtuar automjetin e udhëtarëve “Audi A3”, ngjyrë e zezë metalike, me tabela të regj. ..., ka rrezikuar trafikun publik, duke e vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, duke vepruar në kundërshtim me par. 1 të nenit 41 të LSKRR, ashtu që nuk u është përmbajtur rregullave lidhur me obligimin e shoferit, sipas të cilit “shoferi, i cili në rrugë ose ndonjë hapësirë tjetër të trafikut synon të bëjë ndonjë veprim me automjet, si, hyrjen në trafik, rreshtimin, lëvizjen e mjetit në anën e majtë apo të djathtë, ndërrimin e shiritit të trafikut, tejkalimin, anashkalimin, ndalimin e mjetit, kthimin në anën e djathtë apo të majtë, kthimin gjysmë-rrethor, drejtimin e mjetit mbrapa, e të ngjashme, lejohet të fillojë një veprim të

tillë vetëm nëse më parë është i bindur se nuk i rrezikon ose pengon pjesëmarrësit tjerë në trafik, ose nuk e rrezikon pasurinë”, lehtë ka menduar se edhe përkundër këtyre lëshimeve nuk do të shiktojë pasojë të ndaluar, ashtu që me të arritur në vemndin e cekur ka bërë lëvizje të pakujdesshme dhe nuk u ka kushtuar rëndësi pjesëmarrësve tjerë në trafik (fëmijëve dhe biçiklistit, tani të dëmtuarit) dhe për pasojë, me krahun e parë të anës së majtë të automjetit e ka goditur biçiklistin E.A.S., të cilit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjeve të indeve të buta të trupit dhe kokës, me pasoja të përkohshme për shëndetin

-me çka ka kryer veprën penale Rrezikim i Trafikut Publik, nga neni 378 par.6, lidhur me par. 1 të KPRK-së, andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,46,73,114 të KPRK-së, dhe nenit 365, dhe 453 të KPPRK-së.

E G J Y K O N

Të akuzuarën Rr.C., me **Dënim me Gjobë** në shumë prej **200 (dyqind) €**, të cilën gjobë e akuzuara do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën Gjykata do t’ia zëvendësojë me dënim burgu, ashtu që do t’i llogaritet shuma prej 20 €, për një ditë burgimi.

Obligohet e akuzuara që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej **20 (njëzetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Konform **nenit 39 par. 3 nën par.3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit**, të akuzuarës i shqiptohet edhe **taksa në shumën prej 30 (tridhjetë) €**.

Pala e dëmtuar udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur propozim akuzë PP. II. nr. 469/2017, të datës 21.03.2017, kundër të akuzuarës Rr.C., për shkak të veprës penale Rrezikimi i Trafikut Publik nga neni 378 par. 6, lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njejtën ta shpallë fajtores dhe ta denojë sipas ligjit.

Meqenëse e akuzuara Rr.C. e prani fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, I cili pranim është bërë pa presion, pas njoftimit nga ana e gjykatës për benefitet dhe pasojat e pranimit të fajsisë, i cili pranim i fajsisë është në harmoni me provat material të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nuk pati nevojë që të procedohen prova të tjera.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vet pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se e akuzuara Rr.C. e ka kryer veprën penale Rrezikim i Trafikut Publik, nga neni 378, par. 6, lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se e akuzuara e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i saj se në të ardhmen do të jetë më e kujdesshme në vozitje dhe nuk do të kryej vepra penale, ndërsa, si rrethanë rënduese, pati

parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe faktin se këto vepra janë dukuri mjaft e shpeshtë, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të nenit 41 të KPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P. nr. 298/17, më datë 10.12.2018

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të së njejtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.*